



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 10.07.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Donika Kadaj-Bujupi, Nezir Çoçaj, Agim Aliu, Doruntinë Maloku, Milena Miliçević dhe Danush Ademi.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Selviqe Halimi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Agim Çeku, deputet, Daut Haradinaj, deputet, Rexhep Selimi, deputet; Zahir Çerkini dhe Hamit Mjeku, praktikant; Florina Merovci-ZPRK; Blerta Bejtullahu- EUSR/EU Office; Kaltrina Ahmeti -GPLS; Valmire Hoti-Infodirekt. TV; Dukagjin Maliqi-RTV Dukagjini; Leutrim Berisha-Tribuna Channel; Bryan Marcus-US Embassy; Adem Gashi- US Embassy; Rrezarta Zekaj-RTK Radio; Lumturie Bekaj- Kosova Info; Valmir Klaiqi-TOP Channel; Sylë Ahmeti-Kosova Sot; Petrit Hysaj-OSBE; Etleva Ikonja; Shkëlqim Hyseni-KTV.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.05.2015;
3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për krijimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja- konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.05.2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 19.5.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për krijimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës

Kryetarja- Fillimisht falënderoi të pranishmit dhe anëtarët e Komisionit për siguri që janë prezent për këtë çështje të rëndësishme, tani më kemi draft- amendamentet e propozuara nga Qeveria dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, i cili thekson se asnjëri prej këtyre amendamenteve nuk pakëson të drejtat dhe liritë e qytetarëve të Kosovës, njëkohësisht jep dritën e gjelbër për t'u proceduar më tutje, por për shkaqe të tendencave që të ketë një ndarje etnike në Ushtrinë e Republikës së Kosovës në momentin kur jemi ngarkuar si Komision për Legjislacion për t'i proceduar këto amendamente i kam dërguar një shkresë më 9 qershor, ministrit Demolli, ku kam kërkuar, përveç amendamenteve të cilat i kanë proceduar në Kuvendin e Kosovës, le të na i procedoj edhe të gjitha dokumentet relevante, strukturën, organogramin se si do të duket Ushtria e Kosovës, mirëpo z. Demolli me një shkresë tjetër është përgjigjur se ende nuk i kanë këto dokumente finale dhe janë në fazën e fundit dhe ende nuk janë miratuar nga organet përkatëse e që nuk theksohet se cilat janë ato organe përkatëse që do t'i miratojnë. Është evidente Komisioni për Siguri është përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, megjithatë kam dashur ta kem një pasqyrë reale se si do të duket struktura organizative e ushtrisë, Subjekti të cilin e përfaqësoi e përkrah krijimin e ushtrisë dhe konsiderojmë së është një e drejtë e patjetërsueshme dhe i takon secilit vend sovran dhe që garanton integritetin territorial dhe sovranitetin e vendit tonë.

Armend Zemaj- Theksoi se kjo çështje është prolonguar dhe kërkoi sqarime nga kryetarja e Komisionit, për arsye se propozim- amendamentet ka kohë që kanë ardhur në Kuvendin e Kosovës dhe të cilat e kanë marrë miratimin edhe nga Gjykata Kushtetuese, dhe sot jemi në procedim, mendoj që sa më shpejt duhet përcjellë për seancë plenare dhe Kuvendi të vendos për këtë çështje një zëri që Forcat e Sigurisë së Kosovës të shndërrohen në Forca të Armatosura. Në parim, por dhe me bindje të plotë, ka ardhur koha që ne të kemi këtë institucion të kompletuar kushtetues, andaj dhe përkrahjen e plotë, por është e pakuptimtë edhe sot edhe në të ardhmen që terminologjia Republika e Kosovës të mos figurojë si pjesë integrale e Forcave të Armatosura të Kosovës.

Kryetarja- Theksoi se janë të paketën dy arsye për prolongimin e kësaj çështje, E para se kam kërkuar informacione shtesë nga z. Demolli dhe të cilat informacione si kam marrë ende, andaj mbetet t'i drejtohem Komisionit për Siguri. Arsye tjetër dhe e rëndësishme është për shkak tendencës që amendamentet për Ushtrinë e Kosovës të votohen në një pako me Gjykatën Speciale. Por tani më Kuvendi i ka thënë jo Gjykatës Speciale dhe ne po i procedojmë këto amendamente.

Donika Kada-Bujupi- Propozoi që nga ky takim i Komisionit të dalin edhe më një kërkesë shtesë për Qeverinë, pasi që ka thënë se projektligji është i gatshëm, le ta procedojnë për Komisione Funksionale, rrjedhimisht edhe në Komisionin për legjislacion, në mënyrë që ta kalojmë në lexim të parë, dhe pse jo edhe në lexim të dytë para pushimeve verore, është një ndër çështjet jetike për vendin dhe në përgjithësi për zhvillimet në Kosovë dhe rajon.

Rexhep Selimi- Theksoi se këto amendamente nuk janë për herë të parë te ne, sepse kanë qenë edhe në Majin e vitit të kaluar dhe të njëjtat kanë qenë të mbështetura nga të gjitha Grupet Parlamentare, por në mungesë të përkrahjes së komunitetit serb nuk kanë kaluar në atë kohë dhe duket se refuzimi i tyre në atë kohë ka prolonguar deri tash këtë çështje. Shpresoj që tash do i përkrahin sepse edhe ashtu duhet shumica e tyre që t'i përkrah. Duhet ditur se po bëhet fjalë për ndryshime kushtetuese të cilat i paraprin edhe ligjit për Forcat e Armatosura të Kosovës dhe dihet që askush nga ne nuk ka vërejtje, janë disa vërejtje të vogla, por nuk duhet stopuar këtë çështje sepse ekziston vullneti, gatishmëria ekzistojnë edhe draftet ndonëse jo formale, madje ekzistojnë edhe draftet për legjislacion sekondar, ndonëse jo formale. Shqetësimet se mund të ndodhë ngjashëm çfarë ka ndodhur me Policinë e Kosovës është shqetësim i drejtë dhe i arsyeshëm, andaj Ligji për Forcat e Armatosura kur të vjen ta sanksionojmë në gjë të tillë me një nen ose paragraf e mos të lejojmë të ndodh çfarë ka ndodhur me Policinë e Kosovës që është ndarë një pjesë etnike në një region të caktuar.

Agim Aliu- Theksoi se është privilegj për të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës që t'i shqyrtojnë amendamentet që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës dhe ta realizojnë një ëndërr ta kamotshme që edhe vetë populli i Kosovës e pret.

Daut Haradinaj- Theksoi se pret përkrahjen edhe të Listës Serbe për Forcat e Armatosura, sepse neni 126, pika 4, ku ju garanton Komuniteteve që jetojnë në Kosovë, barazi brenda kësaj strukture, pra të gjithë ata që e kanë shtetësinë e Kosovës kanë të drejtë me qenë pjesë e Forcave të Armatosura. Ligji është i gatshëm, jemi në kontakt me ministrin dhe tani këtu kemi edhe ish - ministrin i cili ka bërë një punë të shkëlqyer në mandatin e kaluar dhe ka pasur përkrahje të gjithanshme, po presim pasi të kalojnë këto t'i ndërrohet vetëm Komisionari. Ushtria e Kosovës duhet të jetë unike pa ndarje, për arsye se nuk ka ushtri që e garanton një sovranitet e që ndahet etnikisht sepse nuk ka asnjë logjikë, sepse ka strukturë komanduese dhe për ta marrë detyrën komanduese duhet kohë, trajnim, stërvitje dhe avancim në bazë të rregullores së brendshme do të

thotë nuk mundesh ta marrësh një detyrë ex-officio me një vendim. Do ishte mirë me u quajtur Ushtria e Kosovës, por për shkak të rrethanave kanë gjetur një terminologji pak më të butë, mendoj që edhe kjo fazë është kalimtare. Për fund theksoi se ditën e parë kur drejtohet ministri me Ligjin ne jemi të gatshëm me proceduar pasi që ligji kalon me shumicën e thjeshtë, ndërsa amendamentet kushtuese kërkojnë shumicën e dyfishtë, andaj lus që të bashkëpunojmë edhe me pakicat e tjera që t'i japim mbështetje ndërrimeve kushtetuese.

Agim Çeku- Theksoi se mandatin e kaluar kam qenë ministër i FSK-së dhe jam në dijeni se ky proces është bërë në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, në radhë të parë me SHBA-të të cilët e kanë dërguar dhe ende janë prezent, të kyçur në këtë proces me një ekip të specializuar nga Departamenti i Mbrojtjes në Pentagon, sidomos si ministër kam punuar në nenin 126, kemi negociuar gjatë dhe i kemi harmonizuar. Problemi ka qenë te substanca dhe te emri, kemi filluar nga Ushtria e Kosovës, Forcat e Mbrojtjes së Kosovës, në fund kemi gjetur kompromis për emrin Forcat e Armatosura të Kosovës. Arsyeet pse e kemi zgjedhur Forcat e Armatosura të Kosovës si emër janë të shumta. Për herë të parë kemi futur termin mbrojtje, në nenin 126 përmendet që FAK përmendet se është Forca Ushtarake Kombëtare për Mbrojtje. Përmendet se mbrojnë interesat e Kosovës dhe dihet se interesat e Kosovës nuk janë vetëm brenda kufijve të saj. Është me rëndësi të theksohet se Shefi i mbrojtjes është ushtarak më i lartë, është person politik, merr pjesë në takimet ndërkombëtare, është këshilltari ushtarak i parë i ministrit, i presidentes. Kurse sa i përket Komisionarit, pasi që Ushtria nuk ka të drejtë në organizim sindikal, ky do jetë një omubudsperson për ushtri. Po ashtu në të ardhmen duhet të jetë apo të quhet Komisioni parlamentar për siguri dhe për mbrojtje, kurse komisioni për punë të brendshme dhe inteligjencë duhet të jetë një.

Daut Haradinaj- Theksoi se Komisionari është organ parlamentar do të thotë e zgjedh Kuvendi dhe do t'i raportojë Kuvendit, pra është një ombudsperson i pjesëtarëve apo Forcave të Armatosura dhe të njëjtën kohë është një garantues i ruajtjes së Policisë së Kosovës. Pa është një ruajtës i pjesëtarëve të FAK-ut dhe pjastrave të Policisë së Kosovës.

Agim Çeku- Tha se projektligji është i gatshëm, është projekt ligji për plotësimin dhe ligjeve ekzistuese, por ministria duhet të procedojë projektligjin për mbrojtjen dhe projektligjin për FAK-un.

Rexhep Selimi- Përsëriti se është një pako ligjore që afro 40 Ligje do të pësojnë plotësim-ndryshim, jo esencial, por më tepër nominal, pra ku ka qenë FSK do bëhet FAK.

Dorentina Maloku- Theksoi se do të votojë kundër për arsye të emrit, sepse emri FARK do të ishte ai adekuati dhe nuk ka lidhshmëri me Forcat revolucionare të Kolumbisë, sepse ato shkruhen me "C" FARC.

Kryetarja- Theksoi se në rekomandim të Komisionin nuk mundemi që ta procedojmë, por mund t'i kemi dy propozime:

1. *Për përkrahje të këtyre amendamenteve dhe*
2. *Të procedohen sa më parë dokumentet e tjera relevante.*

Armend Zemaj- Theksoi se Ligji derivon nga Kushtetuta, do të thotë se pa i pasur ndryshimet kushtetuese ne nuk mundemi sot me kërkuar një ligj i cili nuk është në harmoni me Kushtetutën. Andaj t'i procedojmë amendamentet kushtetuese, për arsye se ne nuk i shqyrtojmë, por i përcjellim si mendim të Gjykatës Kushtetuese.

Kryetarja- Tha se faji nga Kryesia e Kuvendit na është hedhur neve, si Komision, për mos procedim, por tani më janë të gatshme. Shpresoj që të enjten të jenë në seancën plenare të rregullt.

Doruntinë Maloku- Theksoi se vota ime nuk është kundër themelimit të FAK-ut, por kundër akronimit FAK.

Kryetarja konstatoi se Komisioni me 7 vota “për” dhe 2 “kundër”, Komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohen amendamentet kushtetuese, që kanë të bëjnë me transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

4. Të ndryshme

a. Angazhimi i ekspertit për Projektligjin për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të Pronave

Armend Zemaj- Theksoi se grupi punues për ligjin për “Agjencinë Kosovare të Pronave” ka mbajtur takimin e saj për përgatitjen dhe procedimin e këtij projektligji. Andaj ne na duhet angazhimi i një eksperti për këtë projektligj. Propozoi që z. Haxhi Gashi të angazhohet si ekspert për këtë Projektligj.

Komisioni e përkrahu propozimin e deputetit Armend Zemaj.

Mbledhja përfundoi në orën 14:05.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
